



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

**NJOFTIM PARAPRAK PËRQËNDRIMI**

Mbi përqendrimin nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë SIGMA I.P.P Sh.a nga shoqëria SICRED Sh.a

Në datën 2 Mars 2011, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të Kontratës për Shitblerje Aksionesh, të nënshkruar ndërmjet palëve (SIGMA Vienna Insurance Group Sh.a në cilësinë e shitësit dhe SICRED Sh.a në cilësinë e blerësit) me objekt përftimin e kontrollit të shoqërisë SIGMA I.P.P Sh.a nga SICRED Sh.a nëpërmjet transferimit të 75% të aksioneve në përputhje me Ligjin Nr. 10 197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse në përqendrim është si vijon:

- SICRED Sh.a: ushtron veprimtarinë e saj në fushën e sigurimit dhe ri-sigurimin e Jetës, në përputhje me Ligjin Nr. 8081 “Për veprimtaritë e sigurimit dhe ri-sigurimit”;
- SIGMA I.P.P Sh.a: ushtron veprimtarinë e saj në fushën e mbledhjes së kontributeve suplementare dhe dhënien e përfitimeve suplementare personave të përfshirë në institutin privat si dhe në përputhje me parimin e shpërndarjes së riskut (diversifikimin) për ofrimin e përfitimeve të pensionit për personat që bashkohen në fondin e pensionit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b dhe 12, pika 1 të Ligjit nr. 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al)**